



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 3692/1 Prot

Dt. 12.07.22



Nr. 442/1 prot.

Shkodër, më 8.07.2022

Lënda: Mbi vendimin nr. 38, datë 27.06.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 49, pika 4, shkronja “e”, neni 54, shkronja “j”, neni 55, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 164, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau Dejës nr. 3690 prot., datë 27.06.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.06.2022”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 38, datë 27.06.2022 “Për miratimin e mbarimit të mandatit përpara afatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, z. Agim Sulejmani”.

Pas trajtimit, Prefekti u njoh për procedurën e ndjekur për mbarimin e mandatit si anëtar i Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të z. Agim Sulejmanit sipas dispozitave ligjore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS



VENDIM

Nr 38 .datë 27.06 .2022

PËR:

“ Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z.Agim Sulejmani”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 2,pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Z. Agim Sulejmani, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 ““ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”

Kryetari Këshillit

Mark BISHA



Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 04.07.2022